



FEDERATA E SHENJËTARISË SPORTIVE E KOSOVËS
SPORTSKA STRELJAČKA FEDERACIJA KOSOVA
KOSOVO SHOOTING SPORT FEDERATION

Adresa: Rr. Agim Ramadani Nr. 43 Shtëpia e Sporteve Prishtinë, Kosovë.
Tel.Fax: ++381 (0) 38 244 473, mobil: +377(0)44 112474
e-mail: info@fshsk.org, gezim.hazrolli@fshsk.org

RREGULLORE ANTI-DOPING E FEDERATËS SË SHENJËTARISË SPORTIVE TË KOSOVËS

Prishtinë 11.11.2022

Në bazë të Nenit 22, alineja 2.21 të Statutit të Federatës së Shenjëtarisë Sportive të Kosovës, Këshilli drejtues në mbledhjen e mbajtur më 11.11.2022 miratoi:

Rregullore Anti-Doping të Federatës së Shenjëtarisë Sportive të Kosovës

I. Hyrje

Këto rregulla anti-doping janë rregulla sportive, që përcaktojnë kushtet nën të cilat zhvillohet sporti i shenjëtarisë. Synimi i këtyre rregullave është që të zbatohen parimet anti-doping në mënyrë të organizuar, brenda sportit të shenjëtarisë, në Republikën e Kosovës.

Rregullat anti-doping synojnë të ruajn dhe promovojnë vlerat e brendshme të sportit të shenjëtarisë. Këto vlera të brendshme, shpesh quhen «shpirti sportiv» dhe janë në thelb të Olimpizmit: synimi i rezultateve të shkëlqyeshme njerëzore, përmes përmirësimit të përkushtuar të talentit natyror, të secilit person.

Shpirti sportiv reflektohet në vlerat që gjenden brenda dhe përmes sportit:

- etika, «fair-play» dhe sinqeriteti
- shëndeti
- shkëlqimi në performansë
- karakteri dhe edukimi
- gëzimi dhe loja
- puna ekipore
- dedikimi dhe përkushtimi
- respekti ndaj rregullave dhe ligjit
- respekti ndaj vetes dhe pjesëmarrësve tjerë
- trimëria
- bashkësia dhe solidariteti

Dopingi është në kundërshtim të plotë me shpirtin sportiv

Federata e Shenjëtarisë dhe secili klub anëtar, janë të përkushtuar në parandalimin e përdorimit të substancave dhe metodave të ndaluara, qoftë me qëllim, ose pa qëllim, në sportin e shenjëtarisë dhe, brenda mundësive të veta, si dhe në bashkëpunim me akterët e tjerë (KOK, ESC, ISSF, MKRS, Agjencia Botërore Anti-Doping), do të planifikojnë, zbatojnë, vlerësojnë dhe mbikëqyrin programet e informimit dhe edukimit, për «sportin pa doping», në të gjitha nivelet e organizimit, me qëllim të ruajtjes dhe zhvillimit të «shpirtit sportiv».

II. Përfshirja

Kjo rregullore përfshinë FSHSK-në dhe të gjithë klubet anëtare

Kjo rregullore vlen edhe për gjithë sportistët, personelin sportivë mbështetës, si dhe çdo person tjetër, që në saje të akreditimit, licencimit, ose marrëveshjes kontraktuale, ose në çfarëdo mënyre tjetër, është pjesë e organizimit dhe aktiviteteve të FSHSK-së dhe/apo klubeve anëtare të FSHSK-së.

III. Përkufizimi

Dopingu përkufizohet si paraqitje e një, ose më shumë shkeljeve të rregullave anti-doping, të parashtruara në këtë Rregullore.

IV. Shkeljet e rregullave anti-doping

Qëllimi i këtij kapitulli, është që të përcaktojë rrethanat dhe sjeljet, të cilat përbëjnë shkelje të rregullave anti-doping. Procedurat disiplinore në rastet e dopingut, do të zhvillohen duke u nisur nga vërtetimi se një, ose më shumë nga këto rregulla, janë shkelur.

Është detyrë e sportistëve, personelit sportivë mbështetës, si dhe personave tjerë, të përfshirë në organizimin dhe aktivitetet e FSHSK-së dhe/apo klubeve anëtare, që të informohen se çka përbënë shkelje të rregullave të dopingut, si dhe me substancat dhe metodat, të cilat janë të përfshira në *Listën e Ndaluar*.

Shkeljet e rregullave anti-doping janë:

1. Prania e një substance të ndaluar, apo e metabolitëve, apo markerëve të saj, në mostrën e sportistit/es

- a) Është detyrë e çdo sportisti/ja/je, që të kujdeset, që të mos futë kurrfarë substance të ndaluar në trupin e tij/saj. Sportistët janë përgjegjës nëse ndonjë substancë e ndaluar, apo metabolit, apo marker i saj, gjendet në mostrën e sportistit/es. Prandaj, nuk është e nevojshme që të dëshmohet qëllimi, gabimi, neglizhenca, apo dija, nga ana e sportistit/es, që të vërtetohet shkelja e rregullave anti-doping.
- b) Dëshmi e mjaftueshme e shkeljes së rregullave anti-doping, do të konsiderohet nëse vërtetohet: (i) prania e substancës së ndaluar, apo e metabolitëve, apo markerëve të saj, në mostrën A të sportistit/es, nëse sportisti/ja nuk pranon të ofrojë mostrën B dhe mostra B nuk është analizuar; (ii) mostra B e sportistit/es është analizuar dhe vërteton praninë e substancës së ndaluar, apo e metabolitëve, apo markerëve të saj, që janë të pranishëm edhe në mostrën A; (iii) mostra B është e ndarë në dy shishe dhe analiza e shishes së dytë, vërteton praninë e substancës së ndaluar, apo e metabolitëve, apo markerëve të saj, që janë të pranishëm edhe në shishen e parë
- c) Duke pranuar substancat, për të cilat në Listën e Ndaluar, ekziston një prag sasiar, prania e çfarëdo sasive të asaj substance të ndaluar, apo e metabolitëve, apo markerëve të saj, në mostrën e sportistit/es, përbënë shkelje të rregullave anti-doping
- d) Si përjashtim nga parimi i përgjithshëm i kësaj kategorie, Lista e Ndaluar, ose Standardet Ndërkombëtare, mundën të saktësojnë ndonjë kriter të veçantë, për vlerësimin e ndonjë substance të ndaluar, e cila mundet të prodhohet edhe nga vetë organizmi.

2. Përdorimi, apo tentim-përdorimi i ndonjë Substance të Ndaluar, ose Metode të Ndaluar, nga sportisti/ja

- a) Është detyrë e çdo sportisti/ja/je, që të kujdeset, që të mos futë kurrfarë **Substance të Ndaluar** në trupin e tij/saj dhe të mos përdorë **Metoda të Ndaluar**. Prandaj, nuk është e nevojshme që të dëshmohet qëllimi, gabimi, neglizhenca, apo dija, nga ana e sportistit/es, që të vërtetohet shkelja e

rregullave anti-doping, për përdorimin e **Substancave të Ndaluar**, ose **Metodave të Ndaluar**.

- b) Suksesi, ose dështimi në përdorimin e **Substancave të Ndaluar**, ose **Metodave të Ndaluar**, nuk është me rëndësi. Mjafton që **Substanca e Ndaluar**, ose **Metoda e Ndaluar**, është përdorur, ose ka pasur tentim përdorimi, që të vlerësohet shkëlja e rregullave anti-doping.

3. Ikja, refuzimi, ose dështimi për t'iu nënshtruar grumbullimit të mostrës

Ikja nga grumbullimi i mostrës, ose refuzimi i dorëzimit të mostrës, pa një arsye të qëndrueshme, pas një njoftimi të paraparë sipas kësaj Rregulloreje, apo ndonjë rregulloreje tjetër anti-doping.

4. Ndikimi, ose tentim-ndikimi, në cilëndo fazë të kontrollit të dopingut

Sjellje e cila zhvlerëson procesin e kontrollit të dopingut, por e cila në vete, nuk është e përfshirë në **Metodat e ndaluar**. Ndikimi do të përfshijë, por nuk do të kufizohet: ndërhyrja, ose tentim-ndërhyrja e qëllimshme ndaj zyrtarit të kontrollit të dopingut, dhënia e të dhënave të rrejshme tek një organizatë anti-doping, frikësimi, apo tentim-frikësimi i ndonjë dëshmitari të mundshëm.

5. Posedimi i ndonjë Substance të ndaluar, apo Metode të Ndaluar

- a) Nëse një **sportist garues** gjendet në posedim të ndonjë **Substance të Ndaluar**, ose **Metode të Ndaluar**, ose nëse një **sportist jashtë gare**, gjendet në posedim të ndonjë **Substance të Ndaluar**, ose **Metode të Ndaluar**, e cila është e *ndaluar-jashtë-gare*, përveç nëse sportisti/ja do të dëshmojë se posedimi është në përputhje me rregullat e *lejespër përdorim terapeutik* (LPT), e cila është lëshuar në përputhje me këtë Rregullore, ose ndonjë arsyetim tjetër të qëndrueshëm.
- b) Nëse një **personel sportiv mbështetës garues** gjendet në posedim të ndonjë **Substance të Ndaluar**, ose **Metode të Ndaluar**, ose nëse një **personel sportiv mbështetës jashtë gare**, gjendet në posedim të ndonjë **Substance të Ndaluar**, ose **Metode të Ndaluar**, e cila është e *ndaluar-jashtë-gare*, e që ka lidhje me një sportist, garë, ose trajnim, përveç nëse personeli sportiv mbështetës do të dëshmojë se posedimi është në përputhje me rregullat e *lejes për përdorim terapeutik* (LPT), e cila i është lëshuar garuesit, në përputhje me këtë Rregullore, ose ndonjë arsyetim tjetër të qëndrueshëm.

6. Trafikimi, ose tentim-trafikimi me Substancatë Ndaluar, ose Metodatë Ndaluar

7. Administrimi (dhënia), ose tentim-administrimi i një Substance të Ndaluar, ose Metode të Ndaluar, ndaj një sportisti/ja garues/e, ose Administrimi (dhënia), ose tentim-administrimi i një Substance të Ndaluar, ose Metode të Ndaluar, e cila është e *ndaluar-jashtë-gare* ndaj një sportisti/ja/je jashtë gare

8. Bashkëfajësia

Asistimi, shtytja, nxitja, ndihma, komplotimi, mbulimi, apo çfarëdo lloj bashkëfajësie tjetër, e qëllimshme, që ka të bëjë me rregullat e anti-dopingut, e kryer, ose në tentativë, nga ndonjë person tjetër.

9. Shoqërimi i ndaluar

Kur një sportist, ose ndonjë person tjetër, i cili i nënshtrohet autoritetit të ndonjë organizate anti-doping, ka lidhje profesionale, ose lidhje tjetër, që ka të bëjë me sportin, me një personel sportiv mbështetës, i cili:

- a. Është shpallur i *përfshirë* nga një organizatë anti-doping; apo
- b. Është dënuar, ose ndaj të cilit, në një proces penal, disiplinor, ose profesional, është vërtetuar se ka qenë i përfshirë në sjellje, e cila do të përbënte shkelje të rregullave anti-doping, nëse këto rregulla do të vlenin për personin e tillë.
- c. Shërben si ndërmjetës, ose ndihmës për personin e përkthyer në paragrafët a. dhe/apo b.

Që të zbatohet kjo dispozitë, sportisti/ja duhet të jetë paraprakisht i njoftuar nga një organizatë anti-doping, që ka jurisdiksion ndaj sportistit/es të tillë, se personi me të cilin ai/ajo është në shoqërim, është i *përfshirë*, si dhe të njoftohet për pasojat e shoqërimit të tillë. Gjithashtu, duhet të vërtetohet se sportisti/ja, ka mundësi të evitohet shoqërimin e tillë.

Që kjo dispozitë të përjashtohet, sportisti/ja duhet të dëshmojë se shoqërimi me personelin sportiv mbështetës, të përkthyer në paragrafët a. dhe/apo b. më sipër, nuk është i natyrës profesionale dhe nuk ka lidhje me sportin.

Organizatave anti-doping, të cilat kanë të dhëna për ndonjë personel sportiv mbështetës, i/e cili/a përmbushë kriteret e përkthyer në paragrafët a. dhe/apo b. më sipër, do të njoftojnë Asociacionin Botëror Anti-Doping (ABAD)

V. Dëshmia e dopingut

1. Barra e dëshmisë dhe standardet e dëshmive

FSHSK është e ngarkuar me barrën për të dëshmuar se ka ndodhur shkelje e rregullave anti-doping

Standardi i dëshmisë do të jetë që FSHSK të bindë panelin shqyrtues për shkeljen e rregullave anti-doping, duke pasur parasysh seriozitetin e pretendimit.

Ky standard, në të gjitha rastet, është më i lartë se dëshmia se *është e mundur*, por më i ulët se dëshmia *përtej çdo dyshimi*.

Kur kjo Rregullore e ngarkon *sportistin*, apo *personin* për shkelje të rregullave anti-doping, me barrën e dëshmisë për të kundërshtuar pretendimin, ose për të ofruar faktet, ose për të sqaruar rrethanat, atëherë, standardi i dëshmisë do të jetë dëshmia se *është e mundur*.

2. Metodave për të vërtetuar faktet dhe pandehjet

Faktet lidhur me shkeljet e ndonjë rregullore anti-doping, mund të vërtetohen përmes çfarëdo mjeti, ose mënyre, të besueshme, duke përfshirë edhe pranimin e fajit. Rregullat në vijim për dëshmitë, do të zbatohen në procedurat lidhur me dopingun:

- a) Metodave analitike, shkencore, të miratuara nga ABAD
- b) Metodat analitike, sipas Standardeve Ndërkombëtare për Laboratorët
- c) Dëshmitë të vërtetuara me vendim të plotëfuqishëm Gjykatë, ose me vendim të ndonjë tribunali profesional-disiplinor, me jurisdiksion mbi çështjen e caktuar, kur kanë të bëjnë me sportistin, apo personin ndaj të cilit zhvillohet procedura, do të jenë dëshmi të pakundërshtueshme kundër atij sportisti/ja, ose personi.
- d) Paneli shqyrtues, gjatë një procedure për shkeljen e rregullave anti-doping, mundet të nxjerr përfundim kundër sportistit/es, ose personit ndaj të cilit

zhvillohet procedura, nisur nga refuzimi për paraqitje në procedurë, në rastet kur kërkesa/njoftimi është bërë paraprakisht dhe në kohë të mjaftueshme.

VI. Lista e Ndaluar

- a) Për këtë Rregullore Anti-Doping, FSHSK do të zbatojë Listën e Ndaluar, të miratuar nga Agjencia Botërore Anti-Doping https://www.wada-ama.org/sites/default/files/2022-03/2022list_explanatory_list_en_0.pdf
- b) Përveç nëse është ndryshe theksuar në Listën e Ndaluar, apo në revidimet e saj, Lista e Ndaluar dhe revidimet e saj, do të hyjnë në fuqi menjëherë, pasi të jetë publikuar nga ABAD, pa pasur nevojë për ndonjë veprim nga ana e FSHSK-së, ose klubeve anëtare. Të gjithë personat e përfshirë në këtë Rregullore, janë të detyruar të zbatojnë Listën e Ndaluar, si dhe revidimet e saj, prej datës kur ato hyjnë në fuqi. Është detyrë e tyre, që të njoftohen me kohë me përmbajtjen e Listës së Ndaluar dhe revidimet e saj.
- c) Alkooli nuk përfshihet në Listën e Ndaluar në sportin e shenjëtarisë. Megjithatë, alkooli është i rrezikshëm për shëndetin e sportistëve. Përveç kësaj, alkooli paraqet rrezik për sigurinë në poligone të shenjëtarisë. Çdo sportist, ose person tjetër, që shfaqë shenja të alkoolizimit, menjëherë do të përjashtohet nga poligoni. Mjete përkatëse munden të përdoren, me qëllim të lehtësimit të vendimeve lidhur me këtë çështje.

VII. Leja për Përdorim Terapeutik

- a) Prania e një **Substance të Ndaluar**, ose **Metabolitëve**, ose **Markerëve**; dhe/apo **Përdorimi** apo **Tentim-Përdorimi**, **Posedimi**, ose **Administrimi**, ose **Tentim-Administrimi** i një **Substance të Ndaluar**, ose **Metode të Ndaluar**, nuk do të konsiderohet shkelje e rregullave anti-doping, nëse është në përputhje me dispozitat e LPT, lëshuar me Standardet Ndërkombëtare për Leje për Përdorim Terapeutik.
- b) Aplikimi në FSHSK për të marr Leje për Përdorim Terapeutik, duhet të bëhet menjëherë kur të paraqitet nevoja (përpos në raste emergjente), së paku 30 ditë para se sportisti/ja të marr pjesë në gara.
- c) Përveç në rastet emergjente, nëse sportisti/ja, apo personi, nuk ka bërë aplikim me kohë për të marr LPT, së paku 30 ditë përpara pjesëmarrjes në garë dhe/apo nëse FSHSK nuk e ka njoftuar sportistin, apo personin, se i është miratuar Leja për Përdorim Terapeutik, sportisti/ja, apo personi, nuk do të lejohet të marr pjesë në gara. Nëse sportisti/ja, apo personi, merr pjesë në gara dhe testohet «pozitiv» në ndonjë kontroll doping, qoftë në **garë**, ose **jashtë gare**, do të konsiderohet si shkelje e rregullave anti-doping me të gjitha pasojat.
- d) Skadimi, anulimi, revokimi, kthimi i LPT
 1. LPT e lëshuar sipas këtyre rregullave anti-doping: (i) do të skadojë automatikisht pas përfundimit të afatit për të cilin është lëshuar, pa nevojë për ndonjë njoftim apo formalitet tjetër; (ii) mundet të anulohet, nëse sportisti/ja nuk i përmbahet të gjitha kushteve të cilat janë parashtruar nga Komisioni për LPT, me rastin e lëshimit të LPT-së; (iii) mundet të revokohet nga Komisioni i LPT-së, nëse pas lëshimit të LPT-së, vërtetohet se kushtet përkatëse nuk janë plotësuar; (iv) mundet

të kthehet, pas rishikimit nga Komisioni i LPT-së, ose Komisioni i Ankesave.

2. Sportisti/ja nuk do të ketë pasoja për shkak të përdorimit, posedimit, ose administrimit të **Substancës së Ndaluar**, ose **Metodës së Ndaluar**, në përputhje me LPT, përpara datës së skadimit, anulimit, revokimit, ose kthimit të LPT-së

VIII. Testimi dhe hetimet

1. Qëllimi i testimit dhe hetimeve

- a) Testimi dhe hetimet do të kryhen vetëm për qëllim të parandalimit të dopingut. Këto procedura do të udhëhiqen në përputhje me dispozitat e Standardeve Ndërkombëtare për Testim dhe Hetime.
- b) Testimi do të kryhet me qëllim të vërtetimit nëse sportisti/ja zbaton (ose nuk zbaton) dispozitat e Rregullores për praninë, apo përdorimin e **Substancave të Ndaluar**, apo **Metodave të Ndaluar**. Të gjitha procedurat, do të ushtrohen në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Testimit dhe Hetimit (SNTH).
- c) FSHSK do të përcaktojë numrin testeve përfundimtare, testeve të rastësishëm, si dhe testeve të fokusuar, në përputhje me SNTH. Të gjitha dispozitat e SNTH do të jenë të vlefshme lidhur me të gjitha testet e tilla.
- d) Hetimet do të kryhen në rast të çfarëdo dyshimi, për të vërtetuar nëse ka ndodhur shkelje e rregullave anti-doping.
- e) FSHSK do të vlerësojë informatat lidhur me shkeljet e mundshme të rregullave anti-doping, nga të gjitha burimet e mundshme, me qëllim të zhvillimit të një plani gjithpërfshirës të testimit, si dhe hetimeve lidhur me shkeljet e mundshme të rregullave anti-doping
- f) Çfarëdo të dhëna që grumbullohen gjatë kryerjes së testimit dhe/apo hetimit lidhur me dopingun, do të përdoren dhe ruhen në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

2. Autoriteti për kryerjen e testeve

- a) FSHSK është e autorizuar të kryej të gjithë testimet e sportistëve dhe personave tjerë, që janë të përfshirë në këtë Rregullore.
- b) FSHSK mundet të kërkojë nga çdo sportist dhe person, i përfshirë në këtë Rregullore, që të dorëzojë mostër testimit, në çdo kohë dhe në çdo vend.
- c) Nëse FSHSK ka vendosur të delegojë procedurën e testimit tek ndonjë Organizatë Anti-Doping, vendore ose e huaj, organizata e tillë, do të ketë autoritet që të kërkojë mostra shtesë, ose të kërkojë analiza shtesë. Nëse mostrat shtesë janë marrë, ose analiza shtesë janë kryer, organizata do të njoftojë FSHSK-në.

3. Testimi në gara

1. FSHSK është e autorizuar të kryej testimet, në garat të cilat i organizon. Kur garat organizohen nga ndonjë autoritet tjetër, grumbullimi i mostrave dhe kryerja e testeve, do të bëhet nga autoriteti organizues.

4. Koordinimi i testimit

- a) Kurdo që është e mundur, testimi do të koordinohet nga FSHSK, me qëllim të arritjes së efektit maksimal dhe për t'i ikur testeve të shumëfishta.

5. Vendndodhja e sportistëve

- a) FSHSK do të mbajë informata për vendndodhjen (adresën) e sportistëve dhe personave tjerë, të cilët duhet t'i nënshtrohen testimin dhe do t'i vë këto informata, në dispozicion të Organizatës Anti-Doping, e cila është e ngarkuar me kryerjen e testimin
- b) Sportistët dhe personat tjerë, të cilët përfshihen në këtë Rregullore, do të njoftojnë FSHSK për adresën e tyre, çdo tremujor; do të përditësojnë të dhënat e adresës sipas nevojës, në mënyrë që të jenë të sakta dhe të plota, në çdo kohë; do të jenë në dispozicion për të kryer testimin, në adresën e caktuar
- c) Dështimi i sportistit/es që t'i nënshtrohet testimin, në adresën të cilën e dhënë, do të konsiderohet dështim në dhënien e mostrës, ose testim i huqur, siç është përcaktuar në SNTH
- d) Të dhënat e vendndodhjes së sportistëve do të vihen në dispozicion të Organizatave Anti-Doping, që kanë autoritet për kryerjen e testimin, do të mbahen në konfidencë të potë dhe në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Këto të dhëna do të përdoren vetëm për qëllime të përcaktuara në këtë Rregullore, si dhe do të shkatërrohen ligjin, pasi më të mos jenë relevante për qëllimin për të cilin janë grumbulluar.

6. Analiza e mostrave

- a) Analiza e mostrave do të kryhet në laboratore të akredituara, në përputhje me SNTH. FSHSK do të përcaktojë laboratorët e akredituara, ku do të kryhet testimi.
- b) Mostrat do të analizohen për të gjetur **Substancave të Ndaluar** dhe **Metodave të Ndaluar** dhe substancave tjera, sipas udhëzimeve të ABAD; ose për të saktësuar parametrat relevant në urinën, gjakun, apo mostrave tjera, të sportistit/es, duke përfshirë edhe ADN; ose për çfarëdo qëllimi tjetër ludhur me dopingun. Mostrat mund të grumbullohen dhe të ruhen për analiza të mëvonshme.
- c) Mostrat do të analizohen në përputhje me këtë Rregullore dhe me SNTH.
- d) Mostrat nuk mund të përdoren për qëllime kërkimore, pa miratimin e sportistit/es. Nëse mostrat përdoren për çfarëdo qëllimi tjetër, përpos analizave të parapara në SNTH, atyre do t'u hiqen të gjitha të dhënat identifikuese.
- e) Laboratorët do të analizojnë mostrat dhe do të raportojnë rezultatet, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare për Laboratorët.
- f) Mostrat mund të analizohen edhe në kohë të mëvonshme, në rastet kur dyshohet për shkelje të rregullave anti-doping.

IX. Menaxhimi i rezultateve

- a) FSHSK është përgjegjëse për menaxhimin e rezultateve të testimin
- b) Kushdo që ka kryer rezultatet në emër të FSHSK-së (në bazë të autoriteti, ose në bazë të një kontrate me FSHSK-në), duhet që rezultatet e testimin, t'i dërgojë në FSHSK, në mënyrë të koduar, me raport të nënshkruar nga zyrtari përgjegjës i laboratorit. I gjithë komunikimi, duhet të kryhet në mënyrë konfidenciale dhe në përputhje me standardet përkatëse ndërkombëtare.
- c) Në rast të ndonjë *shmangie nga norma*, FSHSK do të shqyrtojë nëse: (a) ekziston ndonjë LPT, e lëshuar në përputhje me Standardet për Leje për Përdorim Terapeutik, apo (b) ekziston ndonjë *shmangie nga SNTH*, apo Standardet Ndërkombëtare për Laboratorët, që ka shkaktuar *shmangien nga norma*.

- d) Nëse ekziston ndonjë arsye nga pika 3. më sipër, që ka shkaktuar *shmangien nga norma*, atëherë, i gjithë testi do të konsiderohet „negativ“ dhe për këtë do të njoftohet sportisti/ja dhe klubi përkatës.
- e) Nëse *shmangia nga norma* nuk është shkaktuar nga ndonjë arsye e përmendur në pikën 3. më sipër, atëherë, FSHSK do të njoftojë sportistin dhe klubin e tij/saj përkatës për: (a) përmbajtjen e *shmangies nga norma*, (b) rregullin anti-doping i cili është shkelur, (c) të drejtën e sportistin që të kërkojë testimin e mostrës B, apo njoftimin se në mungesë të një kërkesë të tillë, do të konsiderohet se sportisti/ja ka hequr dorë nga kjo e drejtë, (d) datën, kohën dhe vendin për testimin e mostrës B, nëse sportisti/ja, apo FSHSK vendosë të kryej testimin, (e) të drejtën e sportistit/es, apo përfaqësuesit/es të tij/saj, që të jetë i pranishëm gjatë hapjes dhe testimit të mostrës B, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare për Laboratorët, (f) të drejtën e sportistit/es që të kërkojë kopje të dokumentacionit laboratorik të testimit të mostrave A dhe B. Nëse FSHSK vendosë që *shmangia nga norma* nuk përbënë shkelje të rregullave anti-doping, do ta njoftojë sportistin përkatësisht.
- f) Nëse është kërkuar nga sportisti/ja, ose nga FSHSK, që të kryhet testimi i mostrës B, atëherë, do të ndërmerren hapat e nevojshëm, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare për Laboratorët. Sportisti/ja mundet të pranojë rezultatet e testimit të mostrës A, duke hequr dorë nga testimi i mostrës B. Megjithatë, FSHSK mundet të vendosë që të kryej testimin edhe të mostrës B.
- g) Sportisti/ja, ose përfaqësuesi/ja i tij/saj, mundet të jetë i/e pranishëm gjatë hapjes dhe analizës së mostrës B. Gjithashtu, përfaqësuesi nga FSHSK- ja dhe klubi i sportistit, do të lejohen të jenë të pranishëm.
- h) Nëse analiza e mostrës B nuk vërteton rezultatin e analizës së mostrës A (përveç nëse FSHSK vendosë që rastin ta futë në procedurë shqyrtimi për shkelje të rregullave anti-doping), i gjithë testi do të konsiderohet „negativ“ dhe për këtë do të njoftohen sportisti/ja dhe klubi i tij/saj.
- i) Nëse analiza e mostrës B vërteton rezultatin e analizës së mostrës A, për këtë do të njoftohen sportisti/ja, klubi i tij/saj, si dhe organizata anti-doping përkatëse.

X. Masa e suspendimit të përkohshëm

- a) Në rast të paraqitjes së *shmangies nga norma* në rezultatin e mostrës A, është e detyrueshme që sportistit t'i shqiptohet masa e ***suspendimit të përkohshëm***.
- b) Masa e suspendimit të përkohshëm mundet t'i shqiptohet sportisti/ja, apo personit tjetër, në rastet e tjera kur dyshohet për shkelje të rregullave anti-doping.
- c) Nëse është shqiptuar masa e suspendimit të përkohshëm, sportisti/ja, ose personi tjetër, kanë të drejtë për: (a) shqyrtim fillestar përpara shqiptimit të masës, ose sa më shpejtë pas shqiptimit të masës; (b) shqyrtim përfundimtar të përsheptuar pas shqiptimit të masës. Gjithashtu, sportisti/ja, ose personi, ka të drejtë të paraqes ankesë ndaj masës së suspendimit të përkohshëm.
- d) Nëse sportistit i është shqiptuar masa e suspendimit të përkohshëm pas testimit të mostrës A, ndërsa testimi i mostrës B nuk vërteton rezultatin e *shmangies nga norma* të mostrës A, atëherë, masa e suspendimit të përkohshëm hiqet, ndërsa sportisti/ja (dhe klubi i tij/saj) mundet të marr pjesë në gara e më vonshme. Në rast se gara ka filluar në ndërkohë që sportisti/ja ka qenë nën masën e suspendimit të përkohshëm, sportisti/ja mundet të kyçet në garë, nëse kjo nuk e dëmton zhvillimin e garës.

- e) Në rastet kur sportisti/ja është njoftuar për *shmangien nga norma*, por ende nuk i është shqiptuar masa e suspendimit të përkohshëm, sportisti/ja mundet vullnetarisht ta pranojë një masë të tillë, deri në zgjidhjen e çështjes.

XI. Zgjidhja pa shqyrtim

- a) Sportisti/ja, ose personi tjetër, ndaj të cilit është ngritur pretendimi për shkelje të rregullave anti-doping, mundet të heqë dorë nga shqyrtimi dhe të pranojë pasojat sipas rregullave anti-doping, të parapara nga ISSF.
- b) Nëse sportisti/ja, ose personi tjetër, ndaj të cilit është ngritur pretendimi për shkelje të rregullave anti-doping, dështon të kundërshtojë pretendimin, brenda afatit të paraparë në njoftimin e dërguar nga FSHSK, atëherë konsiderohet se ai/ajo, ka pranuar shkeljen e rregullave anti-doping dhe ka pranuar pasojat sipas rregullave anti-doping, të parapara nga ISSF.
- c) Në rastet e mësipërme, nuk do të ketë dëgjim para panelit shqyrtues. Në vend të kësaj, FSHSK do të lëshojë menjëherë vendimin me shkrim, me të cilin vërtetohet shkelja e rregullave anti-doping, pasojat të cilat do të zbatohen, si dhe arsyetimin për çfarëdo periudhe të *përrjashtimit* të sportistit/es. Vendimi i tillë do t'i dërgohet sportistit/es, apo personit tjetër, organizatës anti-doping përkatëse, me këshillën juridike për ankesë. FSHSK do ta bëjë publik vendimin e vet, në përputhje me dispozitat statutoare.

XII. E drejta për shqyrtim të drejtë dhe të paanshëm

1. Parimet për shqyrtim të drejtë dhe të paanshëm

- a) Kur FSHSK ka dërguar një njoftim për sportistin, me pretendimin për shkelje të rregullave anti-doping, ndërsa personi nuk ka hequr dorë nga e drejta për shqyrtim, atëherë, lënda do t'i dërgohet komisionit disiplinor të FSHSK-së, në përgatitje për shqyrtim, i cili do të caktojë një panel shqyrtues për këtë çështje.
- b) Shqyrtimi do të planifikohet dhe mbahet, brenda afatit të arsyeshëm. Në rastet kur sportisti/ja duhet të marr pjesë në ndonjë garë, shqyrtimi mundet të organizohet në mënyrë të përshpejtuar, nëse kjo është e mundur.
- c) Komisioni disiplinor i FSHSK-së dhe paneli shqyrtues, do të veprojnë në mënyrë të drejtë dhe të paanshme ndaj të gjitha palëve dhe gjatë tërë kohës.
- d) Përfaqësuesi/ja i/e klubit të sportistit/es mundet të marr pjesë në shqyrtim, si vëzhgues. Sidoqoftë, FSHSK do të njoftojë klubin përkatës, me rrjedhën e shqyrtimit, si dhe me rezultatet e dëgjimit.

2. Vendimet

- a) Në fund të dëgjimit, ose në kohë sa më të shkurtër pas dëgjimit, paneli shqyrtues do të lëshojë një vendim me shkrim, i cili përfshinë arsyetimin e plotë për vendimin e marrë, çfarëdo periudhe të *përrjashtimit* e cila i ngarkohet sportistit/es, si dhe arsyetimin (nëse zbatohet) pse nuk janë shqiptuar masat më të rënda të mundshme. Vendimi do t'i shpërndahet sportistit/es, klubit përkatës, Komisioni i Ankesave të FSHSK-së, si dhe organizatës përkatëse anti-doping.
- b) Vendimi i panelit shqyrtues mundet të kundërshtohet tek Komisioni i Ankesave i FSHSK-së, nga të gjitha palët e interesuara, siç parashihet në këtë Rregullore.

- c) Nëse nuk është parashtruar ankesë, atëherë: (a) nëse vendimi është se ka pasur shkelje të rregullave anti-doping, vendimi do të publikohet në përputhje me dispozitat statutore të FSHSK-së; por (b) nëse vendimi është se nuk ka pasur shkelje të rregullave anti-doping, vendimi do të publikohet vetëm pas marrjes së pëlqimit të sportistit/es, ndaj të cilit/ës është marr vendimi. FSHSK do të ushtrojë angazhim të arsyeshëm për marrjen e pëlqimit të tillë dhe nëse pëlqimi merret, atëherë do të bëjë publikimin e vendimit, në tërësi, ose, me redaktimet e caktuara, sipas kërkesës së sportitit/es.

XIII. Zhvlerësimi i rezultateve të garës

Shkelja e rregullave anti-doping, në disiplinat individuale, e dëshmuar me testimin gjatë garës, automatikisht shpie deri tek zhvlerësimi i rezultatit në atë garë, së bashku me të gjitha pasojat e parapara, duke përfshirë edhe heqjen e çfarëdo medaleje, pikëve, ose shpërblimi.

XIV. Masat ndaj individëve

1. Zhvlerësimi i rezultateve të garës gjatë së cilës ka ndodhur shkelja e rregullave anti-doping

Shkelja e rregullave anti-doping gjatë një gare, ose në lidhje me një garë, me vendim të autoritetit i cili organizon garën, mundet të sjell zhvlerësimin e rezultateve të atij individi, i cili ka kryer shkeljen e rregullave anti-doping, me të gjitha pasojat e parapara, duke përfshirë edhe heqjen e çfarëdo medaleje, pikëve, ose shpërblimi

2. Përfshirja për shkak të përdorimit, tentim-përdorimit, apo posedimit të substancës së ndaluara, apo metodës së ndaluara

- a) Periudha e përfshirjes do të jetë katër vite, për shkeljet nga IV.1 IV.2 dhe IV.5, nëse vërtetohet se shkelja ka qenë e qëllimshme
- b) Në rastet tjera nga këta nënkapituj, periudha e përfshirjes do të jetë dy vite.
- c) Fjala „e qëllimshme“ ka për synim të identifikojë sportistët/et mashtrues/e. Pra, kjo fjalë përfshinë sportistin/en i/e cila është përfshirë në sjellje, për të cilën ai/ajo ka ditur se përbënë shkelje të rregullave anti-doping, apo së paku, ka ditur se ekziston rreziku se ajo sjellje përbënë shkelje të rregullave anti-doping dhe megjithatë, ka shpërfillur këtë rrezik. Shkelja e rregullave anti-doping me substanca të cilat janë të ndaluara vetëm gjatë garës, nëse sportisti/ja dëshmon se substanca e tillë është përdorur vetëm jashtë garës dhe/apo është përdorur në kontekst jashtë sportit, nuk do të konsiderohet si „e qëllimshme“.

3. Përfshirja për shkak të shkeljeve tjera të rregullave anti-doping

- a) Periudha e përfshirjes do të jetë katër vite (përveç nëse zbatohen dispozitat e nënkapitujve 5. dhe 6. të këtij kapitulli), për shkeljet e rregullave anti-doping nga kapitulli IV.3 dhe IV.4, përveç nëse sportisti/ja mundet të dëshmojë se shkelja nuk ka qenë e qëllimshme, me ç'rast, periudha e përfshirjes do të jetë dy vite.
- b) Për shkeljet e dispozitave të kapitulli IV.6 dhe IV.7, periudha e përfshirjes do të jetë më së paku katër vite e deri për jetë, varësisht nga serioziteti i shkeljes. Shkeljet e tilla, të kryera nga të miturit, përbëjnë veçanërisht si shkelje serioze. Shkeljet e tilla, të kryera nga personeli sportiv mbështetës, do të rezultojnë në

përfshijmë për jetë. Përveç kësaj, nëse shkeljet e këtyre dispozitave përfshijnë edhe shkelje të ligjeve dhe rregullave jo-sportive, do t'i raportohen organeve përkatëse administrative, profesionale dhe/apo gjyqësore.

- c) Për shkeljet e dispozitave të kapitullit IV.8, periudha e përjashtimit do të jetë dy deri katër vite, vartësisht nga serioziteti i shkeljes.
- d) Për shkeljet e dispozitave të kapitullit IV.9, periudha e përjashtimit do të jetë dy vite, me mundësi të uljes në një vit, vartësisht nga shkalla e fajit të sportistit/es, si dhe rrethanat tjera të rastit.

4. Heqja e periudhës së përjashtimit, për shkak të mungesës së fajit, ose neglizhencës

Nëse sportisti/ja dëshmon se, në rastin konkret, ai/ajo nuk ka faj, ose nuk ka bërë neglizhencë, atëherë, periudha e përjashtimit që do të zbatohet për shkeljen e tillë, do të hiqet.

5. Shkurtimi i periudhës së përjashtimit, për shkak të shkallës së ultë të fajit, ose neglizhencës

- a) Në rastet kur sportisti/ja dëshmon se nuk ka kryer bërë shkelje të rëndë, apo ka shkallë të ultë të fajit, shkurtimi i pasojave, për shkeljet e kapitullit IV.1, IV.2 dhe IV.5, në rast të *substancave specifike*, apo *produkteve të kontaminuara*, do të jetë në mes të: (a) masa më e lehtë: shqiptimi i vërejtjes, pa periudhë të përjashtimit dhe (b) dy vite periudhë e përjashtimit. Masa e shqiptuar do të varet nga shkalla e fajit, ose neglizhencës
- b) Në rastet tjera, kur sportisti/ja dëshmon se nuk ka bërë shkelje të rëndë, apo ka shkallë të ultë të fajit, pasojat mund të shkurtohen deri në maksimum gjysmën e periudhës së përjashtimit, e cila do të zbatohet në rastet tjera. Nëse periudha e përjashtimit do të ishte për jetë, atëherë, periudha e shkurtuar e përjashtimit duhet të jetë së paku tetë vite.

6. Heqja, shkurtimi, apo suspendimi i periudhës së përjashtimit, apo pasojave tjera, për shkaqe tjera, përpos fajit

- a) Veprimet sipas këtij nënkapitulli do të ushtrohen në rastet kur sportisti/ja ka ndihmuar ndonjë organizatë anti-doping në zbulimin e shkeljeve të rregullave anti-doping nga ndonjë sportist/e tjetër, ose ka ndihmuar ndonjë organ ligjor ose disiplinor, në zbulimin e ndonjë vepre penale, ose shkeljen e rregullave profesionale, nga ndonjë person tjetër. Në vartësi prej shkeljes së kryer nga personi që ka ndihmuar, më së shumti mund të hiqen, ose suspendohen $\frac{3}{4}$ e periudhës së përjashtimit, e cila i është shqiptuar, ose do t'i shqiptohet atij personi.
- b) Nëse ka zbatuar dispozitat nga paragrafi 1. më sipër, atëherë, FSHSK do të njoftojë organizatat përkatëse anti-doping për vendimin e vet, si dhe arsyet për vendimin e tillë.
- c) Nëse sportisti/ja vullnetarisht ka pranuar shkeljen e rregullave anti-doping, përpara se të jetë ftuar për paraqitje të mostrës për testim dhe ky pranim i fajit është e vetmja dëshmi për shkeljen e kryer, atëherë, periudha e përjashtimit do të shkurtohet, për së shumti gjysmën e periudhës që do të shqiptohet sikur mos të kishte ndodhur pranimi i fajit.

7. Shkelje të shumëfishta

- a) Në rast të përsëritjes së shkeljes së rregullave anti-doping, sportistit/es do t'i shqiptohet masa e cila është më e rënda nga sa vijon:
 - a. Gjashtë muaj
 - b. Gjysma e periudhës së përjashtimit, që do t'i jepej në rast të shkeljes fillestare, pa marr parasysh lehtësimet nga kapitulli XIV.6. më sipër
 - c. Dyfishi i periudhës së përjashtimit, që do t'i jepej në rastet tjera të shkeljes së përsëritur, nëse do të trajtohej si shkelje e parë, duke përjashtuar lehtësimet nga kapitulli XIV.6. më sipër
- b) Ndëshkimi i përcaktuar sipas paragrafit të mësipërm, mundet të lehtësohet, në zbatim të kapitullit XIV.6. më sipër
- c) Shkelja e tretë e rregullave anti-doping, si rregull, do të sjell largim të përjetshëm nga sporti i shenjëtarisë sportive, përveç nëse munden të zbatohen lehtësimet nga paragrafi 4. dhe 5. i kapitullit XIV.4 dhe XIV.5, me ç'rast, përjashtimi do të jetë prej tetë vite deri për jetë.
- d) Për qëllime të këtij nënkapitulli, shkeljet e rregullave anti-doping, për të cilat sportisti/ja ka dëshmuar se nuk ka faj, apo neglizhencë, nuk do të konsiderohen si shkelje të rregullave anti-doping.
- e) Shkelje e përsëritur e rregullave anti-doping, do të konsiderohen rastet e shkeljeve, pasi që FSHSK ka njoftuar sportistin për shkeljen fillestare, ose së paku, pasi që FSHSK të ketë ushtruar tërë angazhimin e arsyeshëm për të njoftuar sportistin/en për shkeljen fillestare. Përndryshe, shkeljet do të konsiderohen si një shkelje, ndërsa masat e shqiptuara do të bazohen në shkeljen më të rëndë të kryer.
- f) Nëse pas shkeljes së parë të rregullave anti-doping, FSHSK zbulon se sportisti/ja edhe më herët ka kryer shkelje të rregullave anti-doping, atëherë, FSHSK do të shqiptojë masa shtesë, duke u bazuar në paragrafin 5. më sipër. Të gjitha rezultatet e arritura në mes të dy shkeljeve, do të zhvlerësohen, sipas kapitullit XIV.8.
- g) Për qëllime të këtij nënkapitulli, shkeljet e përsëritura duhet të kenë ndodhur brenda 10 viteve nga shkelja fillestare, që të konsiderohen si përsëritje.

8. Zhvlerësimi i rezultateve në garat pas marrjes së mostrës pozitive, ose kryerjes së shkeljes së rregullave anti-doping

Përpos zhvlerësimit automatik të rezultateve në garë, në të cilën është marr mostra pozitive, sipas kapitullit XIII, edhe të gjithë rezultatet në garat tjera vijuese nga data e marrjes së mostrës (qoftë në garë, apo jashtë gare), ose të çfarëdo shkeljeje tjetër të rregullave anti-doping, e deri në fillimin e suspendimit të përkohshëm, apo fillimit të periudhës së përjashtimit, do të zhvlerësohen me të gjitha pasojat përkatëse, duke përfshirë heqjen e çfarëdo medaleje, pikëve, apo shpërblimi.

9. Pasojat financiare

- a) Në rastet kur sportisti/ja, ose një person tjetër, kryen shkelje të rregullave anti-doping, duke zbatuar parimin e proporcionalitetit, FSHSK mundet të ushtrojë të drejtën e vetë për (a) kompensim të shpenzimeve lidhur me shkeljen e rregullave anti-doping, pavarësisht periudhës së përjashtimit, ose (b) të dënojë sportistin/en me gjobë, pasi periudha maksimale e përjashtimit i është shqiptuar.
- b) Shqiptimi i gjobave financiare, ose kompensimi i shpenzimeve të FSHSK-së, nuk munden të shfrytëzohen si bazë për të shkurtuar periudhën e përjashtimit,

ose ujen e çfarëdo dënimi tjetër, që zbatohet në rast të shkeljes së caktuar, sipas kësaj Rregulloreje

10. Periudha e përjashtimit

- a) Përveç përjashtimeve të mëposhtme, periudha e përjashtimit fillon në datën kur është marr vendimi i panelit shqyrtues, pas dëgjimit përfundimtar. Nëse nuk ka pasur dëgjim përfundimtar, periudha do të fillojë në datën kur sportisti/ja ka pranuar masën e përjashtimit, ose kjo masë është vendosur në ndonjë mënyrë tjetër.
- b) Nëse dëgjimi përfundimtar është vonuar, ose ka pasur vonesa tjera në procedurën lidhur me shkeljen e rregullave anti-doping, të cilat nuk kanë të bëjnë me sportistin/en, atëherë, FSHSK do të fillojë periudhën e përjashtimit përpara dëgjimit përfundimtar, deri në datën kur është marr mostra. Të gjithë rezultatet e garave gjatë periudhës së përjashtimit, duke përfshirë edhe përjashtimit retroaktiv, do të zhvlerësohen.
- c) Nëse sportistit/es i është shqiptuar masa e suspendimit të përkohshëm, ose sportisti/ja ka pranuar me shkrim masën e suspendimit vullnetarisht, kjo periudhë mundet t'i zbritet nga periudha e përjashtimit, e shqiptuar me vendimin përfundimtar.
- d) Periudha përpara fillimit të suspendimit të përkohshëm (qoftë e shqiptuar, ose e pranuar vullnetarisht nga sportisti/ja) nuk do të merret parasysh për zbritje nga periudha e përjashtimit, pavarësisht nëse sportisti/ja vullnetarisht nuk ka marr pjesë në gara, ose pjesëmarrja i është ndaluar nga klubi përkatës.
- e) Këto dispozita lidhur me periudhën e përjashtimit, do të zbatohen edhe për ekipe.

11. Sjellja e sportistit/es gjatë periudhës së përjashtimit

- a) Gjatë periudhës së përjashtimit, sportisti/ja, ose personi tjetër, i përjashtuar, nuk do të marr pjesë në asnjë garë, ose aktivitet tjetër, në asnjë mënyrë, të organizuar nga FSHSK ose klubet anëtare.
- b) Sportisti/ja që gjendet në periudhë të përjashtimit, mbetet i obliguar të dorëzojë mostrën për testim.
- c) Si përjashtim nga rregullat e mësipërme, sportisti/ja i/e cili/ja gjendet në periudhën e përjashtimit, mundet t'i bashkëngjitet ekipit të vetë, ose të shfrytëzojë hapësirat e klubit të vetë, (a) në dy muajt e fundit të periudhës së përjashtimit, ose (b) çerekun e fundit të periudhës së përjashtimit – cilado që është më e shkurtër.
- d) Nëse sportisti/ja, ose personi tjetër, shkelë periudhën e përjashtimit, çfarëdo rezultati i arritur do të zhvlerësohet. Përveç kësaj, një periudhë e re e përjashtimit, që mundet të jetë në kohëzgjatje sa edhe periudha fillestare, do të shtohet në përfundim të periudhës fillestare të përjashtimit. Periudha shtesë e përjashtimit do të varet nga shkalla e fajit të sportistit, ose rrethanat tjera të rastit. Nëse një personel sportiv mbështetës e ndihmon sportistin/en në shkeljen e periudhës së përjashtimit, FSHSK do të shqiptojë masa ndëshkuese edhe ndaj personave që kanë ndihmuar në shkeljen e ndalesës.
- e) Përveç çfarëdo mase ndëshkuese të shqiptuar lidhur me shkeljen e rregullave anti-doping, FSHSK do të ndalojë edhe çfarëdo mbështetje financiare (plotësisht, ose pjesërisht), ose mbështetje tjetër sportive, të cilat i ka pranuar sportisti/ja, ose personi tjetër.

XV. Ankesat

- a) Ndaj çdo vendimi të shqiptuar sipas kësaj Rregulloreje, mundet të ushtrohet ankesa pranë Komisioni i Ankesave të FSHSK-së, siç është përshkruar në këtë kapitull. Sidoqoftë, vendimet e tilla do të mbesin në fuqi, përveç nëse Komisioni i Ankesave i FSHSK-së urdhëron ndryshe.
- b) Komisioni i Ankesave i FSHSK-së nuk është i kufizuar në procedurën e shqyrtimit të ankesës me lëndën, dëshmitë, ose çështje tjera, të cilat janë marr parasysh nga paneli shqyrtues.
- c) Komisioni i Ankesave i FSHSK-së do të pranojë ankesa për vendimet të cilat janë marr nga paneli shqyrtues i Komisionit Disiplinor të FSHSK-së. Komisioni i Ankesave i FSHSK-së nuk është i autorizuar të pranojë ankesa për vendimet që janë marr nga instancat më të larta (p.sh. KOK, ESC, ISSF, etj).
- d) Procedura e ankesës para Komisioni i Ankesave, do të zbatojë parimet dhe rregullat e parapara në këtë Rregullore dhe në aktet tjera normative të FSHSK-së. Parimet kryesore për procedurën e ankesës janë: shqyrtimi me kohë; panel i drejtë dhe i paanshëm; e drejta për të pasur përfaqësues, në shpenzime të veta; si dhe vendim me kohë, me shkrim dhe i arsyeshëm.
- e) Të drejtë për të ushtruar ankesë kanë: sportisti/ja, ose personi tjetër, të cilit i është shqiptuar masa; klubi në të cilin është anëtar sportisti/ja; KOK, ose ndonjë autoritet tjetër, nëse vendimi në fjalë ka ndikim në aktivitetet e tyre. Pavarësisht dispozitave tjera, palë e vetme që mundet të ankimojë vendimin për suspendim të përkohshëm, është sportisti/ja, ose personi ndaj të cilit është shqiptuar vendimi për suspendim të përkohshëm.
- f) Afati për paraqitjen e ankesës pranë Komisioni i Ankesave të FSHSK-së është 21 ditë nga dit kur pala ankuese ka pranuar vendimin e ankimuar. Palët të cilat nuk kanë pranuar vendimin, kanë të drejtë që brenda 15 ditëve nga dita e shpalljes së vendimit, të paraqesin kërkesë për kopje të lëndës së shqyrtuar. Nëse kërkesë e tillë është dorëzuar, pala e interesuar për të dorëzuar ankesë, ka afat prej 21 ditëve pas pranimit të lëndës. Këto afate do të shënohen në Këshillën Juridike të vendimit fillestar.
- g) Palët në procedurën e shqyrtimit të ankesës, janë së paku: sportisti/ja, ose personi tjetër ndaj të cilit është shqiptuar vendimi i ankimuar; klubi në të cilin është anëtar sportisti/ja, ose personi tjetër; pala tjetër e përfshirë në vendimin e ankimuar; KOK ose organizata tjetër, nëse vendimi në fjalë ka ndikim në aktivitetet e tyre.
- h) Vendimet e Komisioni i Ankesave lidhur me ankesën e parashtruar, do t'i dërgohen të gjitha palëve të cilat janë të përfshira në vendim, sidomos palët që kanë të drejtë ankese.
- i) Palët e interesuara, munden të ushtrojnë ankesë ndaj vendimit të Komisioni i Ankesave. Ankesa e tillë do të ushtrohet pranë KOK-ut, ESC, ose ISSF.

Prishtinë 11.11.2022
Kryetari i FSHSK-së
Gëzim Hazrolli

